



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 400/25-23720
Dt: 22.05.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 13 dhe 58 pika a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, si dhe nenit 8 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, duke vendosur lidhur me rekomandimin e Komisionit Vlerësues për subvencionimin e në fushën e Shëndetësisë, me datën 22.05.2026 merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Komisionit për ndarjen e subvencioneve në fushën e Shëndetësisë për mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve të shërimit të qytetareve për sëmundje të rënda.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të realizoj procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë të përgjithshme prej 81,300.00€, për përfituesit sipas listës për subvencione shëndetësore 2026, nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe bartjen e tyre në xhirollogaritë e përfituesve .
3. Pjesë e këtij Vendimi është lista e përfituesve të subvencioneve shëndetësore 2026, së bashku me procesin e Komisionit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit.

Ardian Gjini

për
Kryetar i Komunës së Gjakovës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Procesverbal

Datë:	20.04.2026	Procesmbajtës	Dafina Kazazi Olloni
Vendi:	Komuna e Gjakovës	Zyra:	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Takimi filloi:	Date: 20.04.2026	Takimi mbaroi:	Date 24.04.2026
Pjesëmarrës	Dr.Lumturije Kameri – specialiste e Mjekësisë Familjare QKMF - kryesuese Dafina Kazazi Olloni-udhëheqëse e Sektorit shëndetësisë-DSHMS- anëtare Erblina Dinarama- drejtoreshe-”Shtëpia e Sigurte”– anëtare Mic Muhadri- zyrtar administrativ DA – anëtare Dr Jon Vula-mjek i përgjithshëm ne QKMF – anëtare		
Tema/ Agjenda	<i>Takim kater ditor</i> Vlerësimi dhe Shqyrtimi i aplikacioneve në lëmin e shëndetësisë në Komunën e Gjakovës		
Diskutimi	Takimin e udhëhoqi kryesuesja e grupit, ku janë njoftuar pjesëmarrësit me dinamiken e punës, detyrat dhe përgjegjësit e secilit anëtar të Komisionit Vlerësues lidhur me shqyrtimin e aplikacioneve në lëmin e shëndetësisë. Nga kryesuesja e komisionit , anëtarët gjithashtu janë informuar lidhur me procedurën për themelimin e Komisionit Vlerësues nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sipas vendimit 112/02-16407 te datës 03.04.2026 ne përbërje te; kryesuesit te komisionit dhe 4 anëtar të komisionit Diskutimi: ➤ Njoftimi me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve te shëndetësisë te datës 04.02.2020. ➤ Është bere shqyrtimi i te gjitha kërkesave te qytetareve, të cilët kane aplikuar për ndihma ne lëmin e shëndetësisë dhe është hartuar regjistri i ri me emrat e përfituesve dhe jo përfituesve te subvencioneve te DSHM-se. Prioritet ne listën e përfituesve sipas kriterave te percaktuara ne rregullore i'u është dhënë: ➤ Personave me sëmundje të rënda, dhe me kosto të lartë të shpenzimeve. ➤ Personat qe nuk kanë përfituar nga burimet tjera financiare, ➤ Personat qe nuk kanë përfituar gjate dy viteve te fundit. ➤ Si dhe personat me kushte të vështira socio-ekonomike		



	Lista e jo përfituesve kryesisht është e përberë nga: ➤ Përfituesit e viteve te kaluara, ➤ Si dhe personat te cilat intervenimet mjekësore i kane pasur ne vitet e mëparshme, e cila bie ndesh me kriteret e përcaktuara nga Drejtoria e Shëndetësisë, sipas Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale.
--	---

Përfundimi	Nga total 414 aplikues janë përzgjedhur: 243 - Përfitues, 171 -Jo përfitues, Gjithsejtë shuma e parapare e mjeteve për Thirrjen publike është 81,300.00 Euro
-------------------	--

Rekomandim

Komisioni e emëruar, pas shqyrtimit të të gjitha kërkesave i rekomandon Kryetarit të Komunës Z. Ardian Gjini , listën e nënshkruar për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme .

Anëtarët e komisionit:

- 1 Lumturiye Kameri 
2. Dafina Kazazi- Olloni 
3. Erblina Dinarama 
4. Mic Muhadri 
5. Jon Vula 